



Në mbështetje të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18), dhe nenit 18, paragrafi (5), nenit 71, paragrafi (8) dhe nenit 72, paragrafi (3) të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16 dhe 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.101/19), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut mori:

VENDIM

**për ndryshim të Vendimit për mënyrën e përcaktimit të palëve të lidhura
dhe për kufijtë e ekspozimit
("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 308/20)**

1. Në Vendimin për mënyrën e përcaktimit të palëve të lidhura dhe për kufijtë e ekspozimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 198/20) në pikën 18), paragrafi (2) ndryshon si më poshtë:

"Në përcaktimin dhe mbikëqyrjen e kufirit të ekspozimit ndaj një anëtarit të këshillit mbikëqyrës të bankës (3% e mjeteve vetanake të bankës) nuk përfshihet ekspozimi i bankës ndaj aksionerit që emëroi atë person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta si përfaqësues të tij në këshillin mbikëqyrës të bankës. Shuma totale e ekspozimit ndaj anëtarit të këshillit mbikëqyrës në bankë dhe ekspozimi ndaj aksionarit të cilin ai e caktoi si përfaqësues të tij nuk duhet të kalojë kufirin e ekspozimit për aksionar të bankës të përcaktuar në Ligjin e Bankave (10% ose 25% e mjeteve vetanake të bankës)."

1.2. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**V nr. 02-15/XVII-1/2020
17 dhjetor 2020
Shkup
Veriut**

**Guvernatorja dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska**